



## **UDHËRËFYES për MONITORIMIN, UDHËZIMIN dhe KËSHILLIMIN (MUK) të GJYQTARËVE TË EULEXIT**

### **DOKUMENTI PËRFUNDIMTAR**

Me rastin e Asamblesë së dytë të Gjyqtarëve të EULEX-it, të mbajtur në Prizren më 23 tetor 2008,

Asambleja e përbërë nga këta gjyqtarë: Maria Giuliana Civinini, Kryetare e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it; Guy Van Craen, Zëvendës-Kryetar Olavi Snellman, Andrea Cruciani, Angela Kaptein; Michael Zimmermann, Norbert Koster, Michael Simmons, Gianfranco Gallo, Gerrit-Marc Sprenger, Christine Lindemann-Proetel, Emilio Gatti, Francesco Florit, Klaus Jung, Verginia Micheva-Ruseva, Andreas Schuler, Vladimir Kanev.

Njëzëri miraton **VENDIMIN**

Për aprovimin e Udhëzimeve të MUK-së për MUK nga ana e Gjyqtarëve të EULEX-it.

Maria Giuliana Civinini

Kryetare e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it

## **HYRJE**

Me 10 korrik 2008, Asambleja e Gjyqtarëve të EULEX-it aprovoi dokumentin për Monitorimin, Udhëzimin dhe Këshillimin (MUK) nga Gjyqtarët e EULEX-it. Dokumenti përmbante definicionet e monitorimit, udhëzimit dhe këshillimit nga gjyqtarët e EULEX-it e gjithashtu edhe korniza logjike e MUK-ut.

Në dokumentin e njëjtë, gjithashtu është paraparë që Grupi Punues për Monitorimin, Udhëzimin dhe Këshillimin nga gjyqtarët e EULEX-it (tash e tutje GP për MUK-un) do të mund të themelohej për mbledhjen e grumbullit të raporteve monitoruese tashmë të publikuara prej organizatave dhe institucioneve të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare (siç janë: OSBE-ja, USAID-i, Amnesty International, Human Rights Watch, Ombudspersoni) dhe të ofrojnë udhërrëfyes më konkret dhe praktik për aktivitetet e MUK-ut.

GP për MUK-un pastaj është themeluar me vendimin e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it me 10 korrik 2008. Anëtarët e emëruar të GP për MUK-un ishin gjyqtarët e EULEX-it: Gerrit-Marc Sprenger, Andrea Cruciani, Gianfranco Gallo dhe Juhani Paiho, zyrtar ligjor. Për më tepër, Maria Giuliana Civinini, Kryetare e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it, Ilknur Ozturk, menaxher i programit, Marcella Hendriks dhe Beatrice Trenkmann, Zyrtarë Ligjorë, gjithashtu morën pjesë në disa seanca të GP për MUK-un.

Me 23 tetor 2008, Asambleja e Gjyqtarëve të EULEX-it ka aprovuar dokumentin e tanishëm, i cili paraqet dokumentin e integruar përfundimtar për aktivitetet e MUK-ut për gjyqtarët e EULEX-it. Ky dokument në njërin anë përmban definicionet dhe kornizën logjike të aktiviteteve të MUK-ut dhe në anën tjetër propozon udhëzimet dhe praktikat më të mira të përdoren prej gjyqtarëve të EULEX-it për sigurimin e qasjes së zakonshme dhe të përbashkët në funksionet e MUK-ut.

Gjyqtarët e EULEX-it inkurajohen që të përdorin në tërësi këta udhërrëfyes. Sidoqoftë, ato mbesin përfundimtare dhe aktorët e vetëm përgjegjës të MUK-ut, duke pasur të drejtën dhe përgjegjësinë që të kryejnë funksionet e tyre në mënyrë autonome dhe të pavarur.

## **SISTEMI RAPORTUES**

Gjyqtarët e EULEX-it duhet të raportojnë për aktivitetet e MUK-ut, sipas procedurës vijuese:

- 1) Gjyqtarët e EULEX-it do të raportojnë kurdoherë që e konsideron të duhur apo të dobishme në secilën aktivitet të MUK-ut vetëm te Kryetarja e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it. Raporti me një strukturë të thjeshtë dhe të qartë, sikur ajo që i është bashkangjitur këtij dokumenti do të përdoret prej gjyqtarëve të EULEX-it. Qëllimi kryesorë i raporteve të brendshme të aktiviteteve monitoruese dhe udhëzuese të gjyqtarëve të EULEX-it është të krijohet një vend i përbashkët për rregullimin dhe formimin e strategjive pasuese këshilluese të Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it;
- 2) Secilin muaj, Zyra e Kryetares së Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it, mbi bazat e raporteve individuale të gjyqtarëve të EULEX-it, do të plotësoj pyetësorin

- të përgatitur prej Zyrës së Programit me qëllim të përditësimit me përparimet dhe arritjet e misionit;
- 3) Çdo gjashtë muaj, Kryetarja e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it në bazë të raporteve të gjyqtarëve të EULEX-it do të dorëzoj propozim për raport gjithëpërfshirës në aktivitetet e MUK-ut, Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it për aprovimin e tij;
  - 4) Raporti gjashtë-mujorë i aprovuar për MUK-un ( i cili nuk do të përmbaj referencë të emrave kolegëve të monitoruar kosovar) përfundimisht do të dërgohet prej Kryetares së Gjyqtarëve të EULEX-it tek Zyra e Programit të EULEX-it, i cili është përgjegjës për raportin gjashtë-mujorë që ti dërgohet Këshillit të Bashkimit Evropian, bazuar në Dokumentin Zbatues të Programit.

Me respekt ndaj sistemit të përshkruar raportues, duhet të theksohet se, kundërshtim të aktiviteteve raportuese të institucioneve dhe organizatave të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare (siç janë OSBE-ja, Ombudspersoni, USAID-i, Human Rights Watch, Amnesty International, QNDT-ja) raportet e MUK-ut të gjyqtarëve të EULEX-it nuk do të kenë ndonjë lidhje të drejtpërdrejtë me publikun e jashtëm, por ekskluzivisht natyrë të brendshme. Në lidhje me këtë është e rëndësishë së lartë që gjyqtarët e EULEX-it të ia bëjnë të qartë homologëve të tyre vendorë që prej fillimit aktiviteteve të MUK-ut se informata e siguruar gjatë këtyre aktiviteteve do të mbetet plotësisht sekrete dhe as raportet publike nuk do të miratohen e as çështjet nuk do të diskutohen me apo të përhapen me kolegët e tyre vendorë apo edhe me Kryetarët e Gjykatave (nëse nuk kërkohet ndryshe prej kolegut të monitoruar vendor). Megjithatë, raportet monitoruese nuk do të jenë vetë anonime por do të përbëjnë të gjitha informatat e nevojshme në lidhje me përcjelljen lëndëve apo të gjyqtarëve. Kjo do të lejoj krijimin e bazës së të dhënave të detajuara dhe të dobishme në secilën gjykatë të qarkut për aktivitetet e MUK-ut. Gjyqtarët e EULEX-it prej gjykatave të qarkut do të kenë qasje në raportet e prodhuara prej gjyqtarëve të EULEX-it të gjykatës tjetër të qarkut për të pasur gjendje të qartë dhe gjithëpërfshirëse të dallimeve apo ngjashmërive në sfidat e gjyqësorit në tërë Kosovën. Ky sistem raportues gjithashtu do të ndihmoj, në baza afatgjate, të zbatoj sistemin e integruar të vlerësimit në mënyrë të qartë dhe të drejtë të gjyqësorit kosovar bazuar në etapat dhe treguesit e kualitetit.

## **BAZAT LIGJORE TË AKTIVITETEVE TË MUK-ut TË GJYQTARËVE TË EULEX-it**

...Siç është cekur në pjesën 2.4 të Ligjit mbi Juridiksionin, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Ndarjen e Lëndëve për gjykatësit dhe prokurorët e EULEX-it në Kosovë, “përpos ushtrimit të funksioneve të tyre juridike në pajtim me nenet 3, 4 dhe 5 të këtij ligji, gjykatësit e EULEX-it do të monitorojnë, udhëzojnë dhe të këshillojnë gjykatësit kosovarë duke respektuar kështu parimet e pavarësisë së sistemit gjyqësor dhe në pajtim me modalitetet e themeluara nga ligji aktual dhe nga EULEX KOSOVA.” Më tej, pjesa 3.9 dhe 5.6 e Ligjit mbi Juridiksionin u ofron gjykatësve të BE-së gjatë ushtrimit të funksioneve të monitorimit, udhëzimit dhe këshillimit autoritetin për qasje në fazat e procedurës, në kopje falas të dokumenteve dhe në kërkesë me shkrim për informata në lëndët e mbyllura apo që janë në vazhdim e sipër dhe që janë në juridiksion apo

kompetencë të ndonjë gjykate në Kosovë, përfshirë edhe kërkesën për informata të mëtejme lidhur me ekzekutimin e vendimit përfundimtar apo vendime të tjera të gjykatës. Marrëveshja në mes të Kryetares së Asamblesë, Kryetarit të Gjykatës Supreme dhe Kryetarëve të Gjykatave të Qarkut e nënshkruar me 5 qershor 2008, në përputhje me rrethanat parasheh që:” Gjyqtarët e EULEX-it do ta kenë autoritetin të kenë qasje, së bashku me ndihmën e personelit të EULEX-it (d.m.th.: zyrtarët ligjorë, përkthyesit, etj.) në cilëndo fazë të procedurës penale apo të mbyllur civile që janë në vazhdim e sipër, të marrin kopje falas të dokumenteve dhe të shkresave dhe në kërkesë me shkrim për informata në lëndët e mbyllura apo që janë në vazhdim e sipër dhe që janë në juridiksion të ndonjë gjykate në Kosovë, pavarësisht detyrave (ngarkesave) të tyre në lëndë”.

Ligji kosovar përfaqëson burimin ligjor, i cili ngarkon gjykatësit e EULEX-it me funksionet ligjore e gjithashtu duke monitoruar, udhëzuar dhe këshilluar funksionet e (MUK-ut). Mirëpo, ligji i përmendur nuk ofron definicionin ligjor të këtyre funksioneve shtesë të gjykatësve të EULEX-it. Interpretimi sistematik i këtij ligji sjellë deri te përfundimi që monitorimi, udhëzimi dhe këshillimi përfaqësojnë tri fazat pasuese të një procesi tërësor, qëllimi i të cilit është asistimi dhe mbështetja e gjyqësorit kosovar për të kryer funksionet gjyqësore në pajtim me standardet evropiane dhe mënyrën më të mirë. Ç’është e vërteta, nuk është rastësi që Ligji mbi Juridiksionin nisë me funksionin e monitorimit, i cili është aktiviteti më i pa bezdisshëm, pastaj vazhdon me fazën më të strukturuar të udhëzimit, në raste kur monitorimi ka shfaqë nevojën për veprime të mëtutjeshme, për të përfunduar më tej me ushtrimin formal të fuqisë këshillëdhënëse në raste kur përpjekjet paraprake për të garantuar respektimin e tërësishëm të standardeve evropiane kanë dështuar. Megjithatë, këto tri funksione shtesë, të cilat nga perspektiva logjike dhe ajo teorike, do të mund të ndahen në tri hapa të veçantë dhe gradualë, janë mjaft të ndërlydhura, madje, ato edhe përforcojnë njëra-tjetrën. Prandaj, shihet që më të filluar procesi, gjykatësit e EULEX-it do të aplikojnë këto tri funksione në mënyrë njëkohshme. Ç’është e vërteta, MUK-u paraqet proces sinergjik. Në të vërtetë, funksioni këshillues nuk paraqet hapin e përcaktuar dhe përfundimtar të tërë procesit, duke qenë punë në përparim me nevojë të mëtutjeshme të kthehet prapa edhe një herë në fazën e monitorimit. Sipas së njëjtës logjike, funksionet MUK-ut do të konsiderohen të jenë saktësisht të lidhura me ushtrimin e funksioneve ligjore. Ç’është e vërteta kolegjet e përziera paraqesin arenën më të përshtatshme për aktivitetin e efektshëm të monitorimit dhe udhëzimit.

Përfundimisht, Kryetari i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it mund të përdor rezultatet e procesit të MUK-së për të miratuar vendimet e duhura për zëvendësimin e gjyqtarëve kosovarë me ata të EULEX-it dhe anasjelltas. Kësisoj, pa ndërhyrë në procedurat e zotëruara nga vendorët, Kryetari i Asamblesë së Gjykatësve të EULEX-it mund të ushtrojë fuqinë e zëvendësimit, e cila mund të reflektojë bashkëveprimin (pozitiv apo negativ) ndërmjet procesit të MUK-së dhe bashkëpunimin dhe përpjekjeve të demonstruara nga gjykatësit vendorë si pasojë e këtij procesi.

## MONITORIMI

Monitorimi nënkuptohet si vëzhgimi, vlerësimi dhe raportimi mbi kryerjen e funksioneve përkatëse gjyqësore për identifikimin e përmirësimeve të mundshme. Në veçanti;

monitorimi përbëhet nga vëzhgimi dhe skanimi i kryerjes së detyrave të gjykatësve vendorë në mënyrë që të mund të identifikohen fushat që kanë nevojë për akoma më shumë mbështetje për të plotësuar standardet ndërkombëtare dhe evropiane, udhëzimet, praktikat më të mira të punës dhe kriteret e referencës.

Monitorimi nuk nënkupton ushtrimin e kontrollit individual apo ndonjë lloj tjetër mbikëqyrje e mënyrës sesi funksionojnë gjykatat kosovare.

Monitorimi do të ekzekutohet në një mënyrë jo-diskriminuese dhe me respekt të plotë ndaj pavarësisë së gjykatësve të Kosovës bazuar në parimet e nderimit reciprok dhe barazisë.

Gjithashtu duhet të jetë e qartë që qëllimi i monitorimit nuk nënkupton hetimin e sjelljes së keqe disiplinore apo penale të gjykatësve vendorë. Në rastet e rralla të vëzhgimit të sjelljes së tillë gjatë monitorimit, gjykatësi i EULEX-it nuk do të ndërmarrë ndonjë hap, por do të informojë autoritetet kompetente vendore disiplinore ose ndjekëse.

Monitorimi nuk kërkon rishqyrtim apo kritikë ndaj punës së kryer nga gjykatësit vendorë. Qëllimi i kësaj teknike është vlerësimi i drejtë dhe i paanshëm i efikasitetit të gjyqësisë në Kosovë gjatë aplikimit të parimit përkatës të drejtësisë dhe standardeve ndërkombëtare të Drejtave të Njeriut. Veç kësaj, procesi i monitorimit nuk duhet të nënkuptohet si mundësi shtesë që palët e pakënaqura të apelojnë kundër vendimit të gjykatës për çështjet e tyre.

Gjatë ushtrimit të këtij qëllimi, gjykatësit e EULEX-it do të bashkë ndajnë përvojën dhe të bashkëpunojnë me kolegët e tyre vendorë dhe ndërkombëtarë, të cilët kanë punuar në monitorim të gjykatave siç janë KGJK-ja, OSBE-ja, USAID-i, KB-ja dhe Ombudspersoni.

Është gjithashtu e rëndësishme që t'u epet kolegëve vendorë një rol aktiv në procesin e monitorimit. Ata duhet nxitur për të shprehur mendimet e tyre mbi të metat dhe mungesat në gjykatë dhe ato në gjyqësi në përgjithësi. Gjithashtu, duhet të merren në konsideratë mendimet e tyre mbi mënyrat sesi mund të përmirësohet situata.

Gjykatësit e EULEX-it do të kryejnë monitorimin bazuar në standardet e qarta dhe bashkërisht të aplikueshme ndërkombëtare dhe evropiane, në udhëzimet, në praktikat më të mira të punës dhe kriteret. Sa i përket këtij aspekti, Doracaku i vitit 2003 mbi të Drejtat e Njeriut në Administrimin e Drejtësisë (dhe amendamentet), botuar nga OHCHR-ja, mund të shërbejë si mjet i dobishëm ngaqë me jurisprudencën ndërkombëtare relevante, është i bazuar në burimet kryesore të ndërlidhura me të Drejtat e Njeriut në sektorin e drejtësisë (për shembull, 1950 ECHR; 1966 ICCPR; 1985 Parimet Bazë në Pavarësinë e Gjyqësisë).

Lista e parë më e detajuar e sektorëve të sistemit kosovar gjyqësor, i cili do të monitorohet nga gjykatësit e EULEX-it, mund të gjendet në Dokumentin për Zbatim të Programit edhe pse do të merret parasysh ndryshimi ndërmjet përfundimit të Monitoruesit dhe Raportit për Menaxhim të Programit (për të verifikuar përbushjen e

qëllimeve të misionit) dhe përfundimit të monitorimit (dhe raportimit) të gjykatësve të EULEX-it (për të zbuluar nevojat për monitorim dhe këshillim dhe për të parë përmirësimin e kualitetit të gjyqësisë).

Disa nga fushat që mund të kërkojnë vëmendje të posaçme gjatë procesit të monitorimit mund të jenë:

- Sistemi për ndarje të lëndëve;
- Sistemi për pakësimin e padive të vjetra;
- Shpërndarja e punës;
- Programi për mbrojtjen e dëshmitarëve;
- Qasja në gjykatë,
- Mungesa e korrupsionit dhe diskriminimit;
- Respektimi i kohës së arsyeshme për të marrë vendime;
- Kualiteti i procesit të vendimmarrjes dhe të arsyetimit të vendimeve;
- Marrëdhëniet me avokatët, prokurorët dhe viktimat;
- Ekzekutimi apo zbatimi i vendimeve gjyqësore (penale), dënimit me burgim dhe gjobat;
- Recidivizmi, d.m.th. mënyra sesi gjykatësi apo paneli mund ta kuptojë që i dyshuari apo i pandehuri është dënuar me burg apo me ndonjë sanksionim tjetër (gjobë apo ndonjë tjetër alternativë);
- Hetime të vazhdueshme ndaj të njëjtit të dyshuar apo të pandehur në një rajon tjetër.
- Me çfarë mekanizmi (po që se ka diçka të tillë) mund t'i kumtohen gjykatësit në gjykatën komunale apo në atë të qarkut vendimet e Gjykatës Supreme në çështjet e tij apo në çështjet në përgjithësi.

Aktiviteti monitorues do të bazohet në vëzhgimin e drejtpërdrejtë nga gjyqtarët e EULEX-it dhe në raportet e organizatave/institucioneve tjera. Gjithashtu, një mori burimesh mund të shfrytëzohen:

- Statistikat mbi kërkesat për diskualifikim
- Statistikat mbi kërkesat për ndërrimin e gjykatësit Kosovar me një gjykatës të EULEX-it
- Statistikat e ankesave
- Statistikat mbi anulimin e dëgjimeve (anulimet paraprake dhe anulimet gjatë dëgjimit)
- Statistikat mbi numrin e dëgjimeve për lëndë
- Statistikat mbi kohën e shqyrtimeve
- Statistikat mbi përqindjen e apelimeve
- Statistikat mbi përqindjen e vendimeve të përmbysura
- Vetëvlerësimi nga ana e gjykatësve Kosovarë
- Analiza e medieve

Në princip, monitorimi do të kryhet nga gjykatësit e EULEX-it në gjykatën e njëjtë të qarkut ku ata ushtrojnë funksionet e tyre ekzekutive. Në rrethana të veçanta, Kryetari i

Asamblesë së Gjykatësve të EULEX-it mund të vendosë të emërojë një apo dy gjykatës të EULEX-it të Gjykatës së Qarkut që të monitorojnë një apo dy lëndë në gjykatën tjetër të qarkut.

## **UDHËZIMI**

Nëse monitorimi ka zbuluar zbrazëtira dhe shkelje të përsëritura të standardeve ndërkombëtare dhe evropiane ose hapësira të mundshme për përmirësim, gjykatësit e EULEX-it duhet të fillojnë, bazuar në raportet konfidenciale të monitorimit, aktivitetin e udhëzimit.

Udhëzimi është ndihmë informative, e bazuar në besimin e ndërsjellë dhe respektin profesional, të ndihmojë homologët vendorë që të mbështesin detyrat e tyre sa i përket funksioneve gjyqësore në pajtim me standardet evropiane.

Udhëzimi përfshin trajnimin, duke treguar se si duhet sjellë me detyra specifike, duke ndarë “përvojën”, inkurajimin. Veç kësaj, udhëzimi do të thotë bashkëpunimi me gjykatësit vendorë në atmosferë besimi, profesionalizmi bazuar në respektimin e ndërsjellë. Në lidhje me këtë, puna në panele të përziera vë në pah mënyrën e mësimin dhe udhëzimit bazuar në kopjim. Në veçanti, udhëzimi do të ushtrohet nga gjyqtarët e EULEX-it përmes aktiviteteve në vijim: trajnimi (ndarja e përvojave sa i përket zbatimit të detyrës së veçantë), lehtësimin (krijimi i mundësive për gjykatësit vendorë të zbatojnë teknika të reja), këshillime (ndihma gjykatësve vendorë që të studiojnë pasojat e vendimeve të mundshme) dhe ofrimi i rrjetit (referimi i gjykatësve vendorë te kolegët tjerë vendorë dhe ndërkombëtarë që kanë më shumë përvojë në lëndët ose çështjet e ngjashme); shkëmbimin e përvojave, informatave, mendimeve; bazuar në burimet e duhura ligjore ose eseve doktrinarë apo jurisprudencës ndërkombëtare: propozimi i organizatës me përkrahje të aktorëve kompetent (siç është OSBE-ja, USAID-i, UNDP-ja, Komisioni i BE-së, TPNJ-ja, Këshilli i Evropës), programe trajnimi të shkurtra dhe të qarta ose vizita studimore jashtë vendit.

Veçanërisht, gjatë trajnimit të gjykatësve vendorë, duhet të ceket që edhe pse monitorimi dhe udhëzimi nuk janë aktivitete thjeshtë për ndërtimin e kapaciteteve, ato janë të lidhura ngushtë me ndërtimin e institucioneve. Mbase, një ndër mësimet më të rëndësishme të mësuara gjatë përvojave në misionet është plotësueshmëria esenciale ndërmjet monitorimit-udhëzimit për të drejta të njeriut dhe ndërtimit të institucioneve. Ç’është e vërteta, qëllimi i monitorimit dhe udhëzimit është që të hetohet dhe të verifikohet nëse gjykatat vendore funksionojnë në mënyrë të duhur dhe të kuptohen pikat e forta dhe të dobëta të sistemit të drejtësisë. Bazuar në aktivitetet e sigurta të monitorimit dhe udhëzimit, projektet për ndërtim kapacitetesh do të bazohen në kuptimin tërësor të praktikës së punës, përfshirë këtu edhe pikat e vazhdueshme të dobëta dhe problemet. Së fundi, monitorimi dhe udhëzimi në terren ofron reagime të drejtpërdrejta ndaj efikasitetit të strategjive dhe programeve reformuese gjatë zbatimit të tyre.

Kualitetit i drejtësisë dhe vendimeve ligjore nuk mund të rritet pa pasur “mjetet e duhura për diçka të tillë.” Në rastin e aktivitetit të udhëzimit, mjetet e duhura janë:

- teknikat dhe metodat e punës;
- përmirësimi i vetes dhe metodat për të mësuar veten;
- ligjet vendore;
- traktatet (marrëveshjet) ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe e drejta ndërkombëtare zakonore
- jurisprudenca vendore
- jurisprudenca evropiane dhe ndërkombëtare
- praktikat më të mira të punës
- literatura shkencore

Modeli i mësimit bazuar në paraqitje kur nuk është i aplikueshëm. Në të vërtetë aktivitetet udhëzuese do të duhet të bazoheshin në raportin e barazisë, “në mes të kolegëve”. Gjyqtarët e EULEX-it do të punojnë krah për krah me homologët vendor dhe ata do të integrohen në sistemin vendorë të gjyqësorit. Në lidhje me këtë, gjyqtarët e EULEX-it duhet të kryejnë funksionet e udhëzimit me profesionalizëm, ndjeshmëri, sjellje të mirë etike dhe angazhimin në marrëdhënien e mësimit të dyanshëm.

### **MONITORIMI dhe TEKNIKAT UDHËZUESE**

Siç është përmendur, monitorimi dhe udhëzimi janë qartazi dy aktivitete të ndryshme me qëllime të ndryshme. Megjithatë, prej pikëpamjes praktike, disa teknika mund të përdoren prej gjyqtarëve të EULEX-it në të njëjtën kohë për kryerjen e funksioneve të monitorimit dhe udhëzimit.

Aktivitetet e MUK-ut duhet gjithmonë të zhvillohen në baza konfidencialiteti. Një qasje miqësore rekomandohet duke nënvizuar faktin se gjyqtarët e EULEX-it dhe gjyqtarët kosovar do të punojnë së bashku krah për krah si kolegë në nivel të njëjtë.

Gjyqtarët e EULEX-it do të përdorin teknikat e mëposhtme monitoruese dhe udhëzuese:

### **TAKIMET INDIVIDUALE NË MES TË GJYQTARËVE TË EULEXIT DHE GJYQTARËVE KOSOVAR TË GJYKATËS SË NJËJTË TË QARKUT**

#### **Mbledhjet individuale si aktivitet monitorues dhe udhëzues**

Takimet në mes të gjyqtarëve të EULEX-it dhe gjyqtarëve kosovar janë shembull tipik i teknikës së kombinuar të monitorimit dhe udhëzimit. Në të vërtetë, këto mbledhje do të luajnë dy funksione të ndryshme por të lidhura ngushtë. Në njërin anë, mbledhjet me kolegët kosovar do ti mundësoj gjyqtarëve të EULEX-it të mbledhin informata prej homologëve vendor lidhur me situatën e administratës vendore të gjyqësisë, e cila është qëllimi thelbësor i aktivitetit monitorues. Në anën tjetër, mbledhjet e njëjta gjithashtu do të lejojnë që gjyqtarët e EULEX-it për të ecur përpara, duke filluar me aktivitetin e udhëzimit. Në lidhje me këtë, posa që gjyqtarët e EULEX-it të zbulojnë fushën e sistemit gjyqësor të cilës i nevojitet përmirësim i mëtutjeshëm ata mund të fillojnë aktivitetin udhëzues, duke shkëmbyer mendimet, duke siguruar sugjerime dhe nxitjen e praktikave më të mira.

## **Qasja joformale e mbledhjeve**

Duhet të nënkuptohet që mbledhjet nuk duhet të zhvillohen nga gjyqtarët e EULEX-it sipas strukturës dhe intervistave formale por më mirë si biseda joformale dhe diskutime në mes të kolegëve. Qasja më e zakonshme dhe joformale duhet të ndiqet, duke privilegjuar ndërtimin e vetëbesimit se sa të shënohet distancë në mes të intervistuesit dhe atij që intervistohet.

Në këtë linjë të arsytimit, mbledhjet duhet të zhvillohen nga gjyqtarët e EULEX-it në nivel personal, d.m.th.: se takimet një me një (sy më sy) (natyrisht me ndihmën e përkthyesit apo të zyrtarit ligjor vendor) duhet të preferohen në mbledhje kolektive me përfshirjen e dy apo më tepër gjyqtarëve.

Mund të jetë e këshillueshme për zgjedhjen e vendit që inkurajojnë më tepër qëndrim joformal, si restorantet apo kafet apo zyrat e gjyqtarëve kosovar se sa ato të gjyqtarëve të EULEX-it apo të zyrës së Kryetarit të Gjykatës (prezenca e të cilëve në mënyrë të qartë do të dekurajohet gjatë intervistës me kolegët tjerë).

Gjithashtu duhet të dekurajohet përdorimi i qasjes së listës së kontrollit, me gjyqtarin e EULEX-it duke e pasur para tij ose saj një model të pyetësorit për ta plotësuar apo shënuar në hapësirat përkatëse. Ndoshta vetëm kur është e nevojshme do të ishte e dobishme të merren shënime të shpejta për numrat, statistikatat apo emrat që mundet lehtë të harrohen. Kjo edhe një herë do të shënoj filozofinë tjetër e cila e drejton aktivitetin e MUK-ut të gjyqtarëve të EULEX-it në lidhje me organizatat tjera siç janë: OSBE-ja, USAID-i, Ombudspersoni etj.

Në lidhje me këtë, në fillim të mbledhjes së parë, do të ishte e këshillueshme të përshkruhet sistemi raportues i gjyqtarëve të EULEX-it, e që është i natyrës së brendshme e jo të jashtme. E që është më me rëndësi, gjyqtarët e EULEX-it duhet t'ja bëjnë të qartë që nga fillimi homologëve kosovar se informata e siguruar gjatë intervistave do të mbetet plotësisht sekrete, pa raporte publike të bazuara në përmbajtjen e mbledhjeve dhe me mirëbesim (kur kjo pyetje bëhet apo e këshillueshme) bile me respekt ndaj kolegëve vendorë dhe Kryetarit të Gjykatës.

## **Përmbajtja e mbledhjeve**

Aspekti më i vështirë i mbledhjeve është me siguri se si të rregullohet nevoja për qasje të besueshme dhe joformale me nevojë që të merren informata të hollësishme në aspekte të shumta të aktiviteteve gjyqësore. Në të vërtetë, qasja joformale nuk duhet të nënkuptohet kurrsesi si sipërfaqësore apo e përgjithshme. Në të kundërtën, mbledhjet individuale janë teknika më domethënëse dhe e dobishme e monitorimit dhe udhëzimit, e cila mund të zbuloj informatat aktuale dhe të hollësishme dhe mund të shpie në përmirësime të shquara.

Sa i përket monitorimit, intervistat duhet të tentojnë të mbledhin informata për një numër të çështjeve, siç janë:

- Sistemi për ndarje të lëndëve (SMIL);
- Sistemi për pakësimin e padive të vjetra;
- Shpërndarja e punës;
- Programi për mbrojtjen e dëshmitarëve;

- Qasja në gjykatë,
- Mungesa e korrupsionit dhe diskriminimit;
- Incidentet e kërcënimeve;
- Incidentet e ndërhyrjeve të jashtme
- Paraburgimi (i seancës paraprake) dhe masat alternative
- Respektimi i kohës së arsyeshme për të marrë vendime;
- Ekzekutimi apo zbatimi i vendimeve gjyqësore (penale), dënimit me burgim dhe gjobat;
- Recidivizmi, d.m.th. mënyra sesi gjykatësi apo paneli mund ta kuptojë që i dyshuari apo i pandehuri është dënuar me burg apo me ndonjë sanksionim tjetër (gjobë apo ndonjë tjetër alternativë);
- Hetime dhe gjykime të vazhdueshme ndaj të njëjtit të dyshuar apo të pandehur në gjykatë tjetër të qarkut.
- Me çfarë mekanizmi (po që se ka diçka të tillë) mund t'i kumtohen gjykatësit në gjykatën komunale apo në atë të qarkut vendimet e Gjykatës Supreme në çështjet e tij apo në çështjet në përgjithësi.
- Hetime në vazhdim e sipër kundër të njëjtit të dyshuar apo të pandehur në qarkun tjetër

Me qëllim të mbledhjes së informatave në këto fusha specifike, disa prej pyetjeve të cilat mund tu drejtohen gjyqtarëve kosovar përfshijnë:

- Si i konsideroni ju kushtet e juaja të përgjithshme të punës?
- Sipas mendimit tuaj, cilat janë pengesat kryesore për ushtrimin efikas të funksioneve tuaja gjyqësore?
- Sa është kohëzgjatja mesatare e procedurave?
- Si mendoni ju se do të ishte e mundur të pakësohen lëndët e vjetra dhe kohëzgjatja e procedurave?
- A keni ndonjë procedurë për të cilën keni vështirësi për të sjell konkluzion apo të cilën ju do të dëshironit që gjyqtari i EULEX-it të merret me të?
- A ka ndonjë tribunë apo mbledhje në gjykatën tuaj ku ju mund të shkëmbeni përvojat dhe sfidat tuaja me kolegët e gjykatës së njëjtë? Dhe me kolegët e gjykatave tjera?
- Çfarë është marrëdhënia e juaj me kolegët tuaj? Dhe me kryetarin e gjykatës? Dhe me KGJK-në? Dhe me prokurorët publik? Dhe me avokatët?
- A mendoni se ndarja e vëllimit të punës është e drejtë në gjykatën tuaj?
- A do ta vlerësonit se sistemi për ndarjen e lëndëve në gjykatën tuaj është i drejtë dhe transparent?
- Kur ju vendosni dhe e jepni arsytimin për vendimin, a e përdorni jurisprudencën e mëparshme?
- Nëse po, cilat janë mjetet që ju i përdorni për jurisprudencën?
- A e përdorni ndonjëherë konventat ndërkombëtare dhe jurisprudencën ndërkombëtare?
- Cilat janë fushat e ligjit apo llojet e krimit ku ju mund më së tepërmi të përfitoni nga trajnimi i fokusuar (përqendruar)?

- Cilat mjete teknike dhe pajisje (kompjuterët, cd-të, video konferencat) ju i përfitoni gjatë ushtrimit të funksioneve tuaja?
- A e përdorni ndonjëherë sistemin menaxhues të lëndëve (SMIL)?
- Si mendoni se gjyqtarët e EULEX-it mund të përkrahin sistemin gjyqësorë të Kosovës?

Është thelbësore të vihet re se nuk duhet që secila mbledhje të shtjellojë të gjitha këto çështje. Në të vërtetë, secila mbledhje duhet të koncentrohet në një apo dy aspekte të tyre ndërkaq mbledhja tjetër ka mundësi të përqendrohet në tema tjera. Në këtë mënyrë do të jetë e mundur që gjyqtari i njëjtë (apo tjetër) i EULEX-it të ketë mbledhje të ndryshme me gjyqtarët kosovar pa pasur nevojë të përsërisë pyetjet e njëjta sërish. Kjo natyrisht do ta mbajë përfundimisht të qëndrueshëm interesimin dhe angazhimin e homologëve kosovar.

Sa i përket udhëzimit, e tërë mbledhja është tanimë aktivitet udhëzues së bashku me gjyqtarin e EULEX-it duke shkëmbyer mendimet, duke ofruar sugjerime dhe forcuar praktikën më të mira. Për më tepër, ekziston mundësia për marrjen e qasjes aktive dhe të bazuar në lëndë duke pyetur gjyqtarin kosovar që të shohë në një apo më tepër dosje që ai apo ajo konsideron të jetë më i ndjeshëm apo kompleks. Kjo do të lejonte gjyqtarin e EULEX-it që të sjell diskutimin në një nivel më praktik me përfshirjen e mundshme të gjyqtarit të EULEX-it në zgjidhjen e problemeve të lidhura me lëndët specifike. Kjo mund të bëhet aty në vend për lëndët më të lehta apo duke e shtyrë diskutimin e atyre lëndëve për të cilat nevojiten analiza më të thella dhe të mëtejshme për një datë tjetër.

Gjatë mbledhjeve (takimeve), gjyqtarët e EULEX-it gjithmonë duhet ta mbajnë në mend rrezikun për përjashtim posaçërisht gjatë fazës së procedurës paraprake. Këto dosje duhet të trajtohen me kujdes të posaçëm duke iu shmangur intervenimeve formale në lëndë dhe mbajtjes së nivelit të udhëzimit në nivel shumë joformal, me një ekspozim sa më pak të mundshëm.

## **TAKIMET KOLEKTIVE NË MES TË GJYQTARËVE TË EULEX-IT DHE GJYQTARËVE KOSOVAR TË GJYKATËS SË NJËJTË TË QARKUT**

Kjo do të ndihmojë që të njohin njëri-tjetrin, të forcojë bashkëpunimin dhe gjithashtu ti mundësojë gjyqtarëve të EULEX-it që të njihen më mirë me problemet dhe vështirësitë e ballafaquara prej të gjithë kolegëve vendorë të së njëjtës gjykatë të qarkut. Çështjet e këtyre mbledhjeve gjithashtu mund të jenë diskutimet në kushtet e përgjithshme të disa temave që janë ngritur gjatë takimeve individuale, për të nxitur zgjidhjet e përbashkëta dhe të zakonshme.

## **MBLEDHJET (TAKIMET) ME PERSONELIN E GJYKATËS**

Gjyqtarët e EULEX-it, zyrtarët ligjorë të EULEX-it dhe procesmbajtësit e EULEX-it duhet ta takojnë tërë personelin që punojnë në gjykatat. Zyrtarët ligjorë të EULEX-it dhe procesmbajtësit e EULEX-it duhet posaçërisht të fokusojnë vëmendjen e tyre tek anëtarët

e personelit që janë caktuar në shkrimore, që të njihen plotësisht me rregullat lidhur me regjistrimin e përgjithshëm, me synim të përmirësimit të sistemit.

## **KONTROLLIMI I SHKRESAVE**

Mundësia e gjyqtarëve të EULEX-it për të kontrolluar secilën shkresë dhe dosje janë mjet shumë i dobishëm i monitorimit dhe udhëzimit, e cila duhet të kryhet (siç tashmë është përmendur) brenda kornizave të takimeve individuale me gjyqtarët vendorë.

## **PJESËMARRJA NË SEANCAT GJYQËSORE**

Gjyqtarët e EULEX-it dhe zyrtarët ligjorë të EULEX-it gjithashtu duhet të marrin pjesë, si dëgjues të thjeshtë në disa seanca gjyqësore në gjykatat komunale dhe ato të qarkut. Do të ishte shumë e këshillueshme për të caktuar pjesëmarrjen me gjyqtarin vendorë që është përgjegjës të seancës gjyqësore dhe ti shmanget vizitave të papritura, me qëllim që mos të bëj gjyqtarin vendor të ndihet disi i inspektuar apo i vëzhguar me prezencën e EULEX-it.

## **ASISTENCA NË HULUMTIM**

Gjyqtarët e EULEX-it dhe zyrtarët ligjorë të EULEX-it duhet tu ofrojnë gjyqtarëve vendorë libra doktrinar, artikuj, eseje, studime, hulumtime dhe konventa ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut. Kjo mund të bëhet gjithashtu në bashkëpunim me universitetet, bibliotekat dhe Qendra Juridike e Kosovës

## **SHPËRNDARJA E JURISPRUDENCËS**

Jurisprudenca kombëtare dhe ndërkombëtare duhet ti jetë në dispozicion të gjyqtarëve kosovar. Përpjekje të veçanta duhet të bëhen prej gjyqtarëve të EULEX-it me qëllim të nxjerrjes në pah homologëve vendorë për rëndësinë vendimtare të jurisprudencës në cilindo proces të vendimmarrjes. Komentet e ligjeve të reja dhe kodeve me jurisprudencën relevante (të printuar dhe të përkrahur në CD) duhet gjithashtu të krijohet, me asistencën e aktorëve tjerë kombëtar dhe ndërkombëtar.

## **SHABLLONET**

Gjyqtarët e EULEX-it duhet gjithashtu tu sigurojnë kolegëve të tyre vendorë me shabllonet mbi vendimet, urdhrat e gjykatës dhe arsyetimet e aktgjykimeve. Diskutimet duhet të pasojnë në dallimet, përparësitë dhe mangësitë e shablloneve të propozuara dhe të atyre që ende përdoren prej gjyqtarëve vendorë.

## **TAKIMET ME ODËN E AVOKATËVE TË KOSOVËS**

Kjo do ti lejonte gjyqtarët e EULEX-it që të njihen më mirë me problemet dhe vështirësitë që ballafaqohen avokatët. Për më tepër, mund të tregoj sfidat e mundshme lidhur me marrëdhëniet në mes të gjyqtarëve kosovarë dhe avokatëve.

## **TAKIMET ME ORGANIZATAT TJERA**

Mund të mbahen takimet me organizatat tjera të lidhur me gjyqësorin kosovar, siç janë shoqatat e viktimave dhe OJQ-të, me qëllim që të mësohet lidhur me perspektivat e tyre në gjyqësorin kosovar dhe të diskutohen ato me kolegët vendorë.

## **ASISTENCA NË TRAJNIM**

Edhe pse gjyqtarët e EULEX nuk do të duhej të kryejnë detyrat e ndërtimit të kapaciteteve, megjithatë brenda aktivitetit të tyre udhëzues, ata mund të përkrahin dhe të organizojnë, me përfshirjen e aktorëve kompetent vendorë dhe ndërkombëtar (siç janë: IGJK-ja, OSBE-ja, USAID-i, UNDP-ja, Komisioni i BE-së, Këshilli i Evropës, TPNJ-a, Ministria e Drejtësisë), në programet trajnuese të shkurta dhe të fokusuar apo vizita studimore jashtë vendit.

## **SHPËRNDARJA E RAPORTEVE NË GJYQËSORIN KOSOVAR**

Të gjitha raportet dhe dokumentet e përpiluara prej institucioneve dhe organizatave të ndryshme vendorë dhe ndërkombëtare (siç janë: OSBE-ja, Ombudspersoni, USAID-i, Human Rights Watch, Amnesty International, TPNJ-a) në gjyqësorin kosovar gjithashtu duhet të ndahen me kolegët kosovar.

## **KËSHILLIMI**

Nëse monitorimi dhe udhëzimi nuk korren sukses në kuptimin që disa shkelje të vazhdueshme apo mosfunksionime strukturale vazhdojnë të ndodhin edhe pas zbatimit të aktiviteteve të lartpërmendura, hapi i fundit që duhet të ndërmerret nga gjykatësit e EULEX-it është këshillimi.

Këshillimi përbëhet në pozitat formale dhe zyrtare të marra prej gjykatësve të EULEX-it në mënyrë kolektive në Asamblenë e Gjykatësve të EULEX-it dhe të drejtuar autoriteteve vendorë gjyqësor, legjislativë apo qeveritare që të nxiten veprimet e tyre në fushat përkatëse të kompetencave.

Këshillimi ka tendencë të ofrojë këshilla profesionale autoriteteve kompetente (MD-së, KGJK-së, IGJK-së, Kryetarit të Gjykatave, Gjykatës Supreme, Parlamentit, Fakulteteve Juridike) në çdo temë të dalë nga përvojat e monitorimit dhe udhëzimit.

Këshillimi u drejtohet institucioneve vendorë si i tillë dhe jo homologëve individualë.

Këshillimi u ofron aktorëve kosovarë mendime dhe ide të nevojshme për të intervenuar në fushat e sistemit të drejtësisë, fushat për të cilat është dëshmuar që kanë nevojë për përmirësim të përgjithshëm dhe strukturorë për tu zbatuar në tërë sistemin gjyqësor dhe kjo nuk mund të kryhet me asnjë aktivitet udhëzues të gjyqtarëve të EULEX-it.

Si shembull, nëse mosfunksionimi i vazhdueshëm në sistemin e drejtësisë në Kosovë varet nga niveli i ulët i pagave të gjykatësve vendorë apo në pjesëmarrjen e tepërt të

gjyqtarëve porotë në kolegje apo në mungesë të sistemit të drejtë dhe transparent të ndarjes së lëndëve në gjykata, në pajtim me atributet kushtetuese, gjykatësit e EULEX-it mund të këshillojnë dhe të mbështesin Parlamentin e Kosovës apo KGJK-në për të përpiluar ligje të reja të cilat kontribuojnë në tejkalimin e mosfunksionimeve të lartpërmendura.